

V E N D I M
“PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE “

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga;

GJYQTARE: REGLETA PANAJOTI

Asistuar prej sekretares **Irena Rafti** sot në **dt.16.07.2014 ora 10.00** . mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KËRKUES: **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë** përfaqësuar nga prokurori **Z.Dritan Rreshka** .

OBJEKTI: Vendosjen e sekuestros preventive për procedimin penal nr 2881 dt 28.05.2013.

BAZA LIGJORE: Neni 36 i Kodit Penal dhe neni 274 pika 2 i Kodit te Procedures Penale.

Gjykata, pasi dëgjoi prokurorin që kërkoi pranimin e kërkesës, shqyrtoi materialin procedues bashkalidhur kërkesës ,

VËREN

Nepermjet kerkeses se Prokurorise se Rrethit Tirane, depozituar ne Gjykate ne daten15.07.2014 , kerkohet te vendoset sekuestro preventive mbi pasuri te paluajtshme te regjistruara ne pronesi shtetasve P.M, E.M,L.M prindërit dhe motra e personit nen hetim F.M.

Nga aktet shoqeruese te kerkeses rezulton sa me poshte:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane, bazuar ne materialin kallzues te depozituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit, Drejtoria e Policise se Qarkut, Sektori Kunder Krimin Financiar ka rregjistruar procedimin penal nr. 2881, viti 2013 per vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose aktiviteteve kriminale”, te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Sipas materialit kallzues te policise dhe hetimeve te kryera ka rezultuar deri ne kete fazë të hetimit se shtetasi F.M, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane eshte marre me trafik te lendeve narkotike te llojit heroine dhe per kete aktivitet ai eshte proceduar nga autoritetet gjyqesore zviceriane.

Sipas shkreses *nr. 3724/3 KL, Prot – TE 214/12/BM/13 date 20.06.2014* te Zyres Qendrore Kombetare Interpol Tirana rezulton se ne baze te te dhenave te siguruar nga Interpol Berna/Zvicer eshte gjendur dhe siguruar informacion per shtetasin **F.M**, lindur me date (.....) ne (.....), shtetas serb, i biri i P.M dhe E.S, *alias F.M* lindur me (.....) ne (.....), i biri i **P.M** dhe **E.Z**. Ky person eshte i njohur per:

1. Shkelje te ligjit per droges (trafik i organizuar heroine , posedim dhe konsumim heroine);
2. Vjedhje.

Nga komunikimi ne vijim me Interpol Bernen ne Zvicer eshte siguruar informacion se gjurmet e gishtave te shtetasit F.M jane marre nga autoritetet zviceriane ne date 23.12.1997 per vepren penale te shkeljes se ligjit mbi drogat dhe bashkelidhur shkreses se Zyres Qendrore Kombetare Interpol Tirana eshte edhe pergjigja e siguruar nga autoritetet zviceriane.

Gjithashtu ka te dhena se i dyshuari F.M ka ushtruar aktivitet te trafikimit te lendëve narkotike në vazhdimësi edhe në Republikën e Shqipërisë dhe per kete fakt eshte rregjistruar edhe nje ceshtje penale ku jane perdorur metodat speciale hetimore por nuk është bërë e mundur kapja e ketij te dyshuari ne flagrance per trafikim te lendëve narkotike.

Sipas informacionit të ardhur nga Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Informacionit Kriminal te Policise se Shtetit sqarohet se në sistemin e informacioneve MEMEX në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit rezultojnë informacione per te dyshuarin F.M me Nr.(.....) raportuar nga strukturat për Hetimin e Aseteve Kriminale ne Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe Nr. (.....) raportuar nga strukturat për Narkotikët ne Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë.

Nga veprimet hetimore te kryera dhe hetimi pasuror kriminal jane identifikuar disa pasuri të paluajtshme , te cilat dyshohet se i takojne shtetasit F.M, por qe pronesia e tyre dyshohet të jetë fshehur duke u vendosur ne emer te familjareve (gjinisë të afërt) te ketij shtetasi. Nga informacioni i dërguar organit të akuzës me shkresën me nr 1481/1 prot dt 25.01.2013 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë si dhe shkresës me nr 446/1 prot dt 18.02.2013 të ZVRPPDurrës jane identifikuar dhe provuar keto pasuri:

- A) Në emër të P.M (babai i te dyshuarit F.M), i cili është pensionist figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK (.....) (.....), pasuria me nr.(.....), volum 16, faqe 209, lloji i pasurisë **arë me sipërfaqe 1200 m2** blere sipas kontrates se dates 18.09.2008, me Nr. rep/kol 4084/1074, pranë Noterit Vangjel Daka ne Tirane;**
- I. **Në emër të P.M (babai i te dyshuarit F.M) i cili është pensionist figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK. (.....) (....), **Tirane** me nr.(.....)volum 16, faqe 1, lloji i pasurisë **arë me sipërfaqe 96 m2** blere sipas kontrates se dates 24.05.2005, me Nr.rep/kol /7117/1750 pranë Noteres Mimoza Shehu, Dhoma e Noterise Tirane;**
- I. **Ne emer te P.M , (babai i te dyshuarit F.M), i cili është pensionist figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....)(.....), volum 19, faqe 187, lloji i pasurisë **apartament banimi me sipërfaqe 130 m2;****
- I. **Ne emer te P.M , (babai i te dyshuarit F.M), figuron pasuria e ndodhur ne ZK. (.....) (.....) pasuria me nr.(.....), volum 7, faqe 131, lloji i pasurisë **apartament****

me sipërfaqe 82 m2 blere sipas kontrates se dates 03.04.2002, me Nr.rep/kol/1179/157 pranë Noterit Xhevdet Hamzaj;

I. **Ne emer te P.M (babai i te dyshuarit F.M)**, figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (Sauk), pasuria me nr.(.....), volum 9, faqe 247, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 355 m2** blere sipas kontrates se dates 15.01.2004, me Nr.rep/kol/52/11 pranë Noteres Edlina Nini;

1. **Ne emer te P.M , (babai i te dyshuarit F.M)**, figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (.....), volum 4, faqe 8, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 745 m2** blere sipas kontrates se dates 24.05.2005, me Nr.rep/kol/7117/1750 pranë Noteres Mimoza Shehu, Dhoma e Noterise Tirane;

1. **Ne emer te P.M, (babai i te dyshuarit F.M)**, figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....)(.....), volum 4, faqe 5, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1515 m2 blere sipas kontrates se dates 24.05.2005, me Nr.rep/kol/7714/1741 pranë Noteres Mimoza Shehu, Dhoma e Noterise Tirane;

1. **Në emër të E.M(nëna e te dyshuarit F.M), e cila është pensioniste** figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK. (.....)(.....) Tirane me nr. (.....) volum 5, faqe 133, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 13 000 m2** blere sipas kontrates se dates 05.10.2006, me Nr.rep/kol/757/72 pranë Noteres Edlira Hyseni, perfaqësuar nga vete i dyshuari F.M me Prokure të Përgjithshme me Nr.1249/276, datë 19.06.2006;

1. **Në emër të E.M(nëna e te dyshuarit F.M), e cila është pensioniste** figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (.....), pasuria me nr.(.....), volum 14, faqe 143, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 710 m2**, blere sipas kontrates se dates 01.02.2005, me Nr. rep/kol/887/315 pranë Noteres Mimoza Shehu;

V. **Në emër të E.M(nëna e te dyshuarit F.M), e cila është pensioniste** figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (.....), pasuria nr(.....), volum 14, faqe 140, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1800 m2**, blere sipas kontrates te se njejtes date 01.02.2005, me Nr.rep/kol/882/316 pranë Noteres Mimoza Shehu.

• **Në emër të E.M(nëna e te dyshuarit F.M), e cila është pensioniste** figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (.....), pasuria nr.(.....), volum 14, faqe 137, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1231 m** blere sipas kontrates se dates 01.02.2005, me Nr.rep/kol/886/314 pranë Noteres Mimoza Shehu;

– **Në emër të E.M(nëna e te dyshuarit F.M), e cila është pensioniste** figuron e rregjistruar pasuria e ndodhur ne ZK.(.....)(.....), pasuria me nr.(.....) volum 17, faqe 125, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 260 m2**, e perfaqësuar nga F.M me Prokure të përgjithshme me Nr.1249/276, datë 19.06.2006, te noteres Adelina Nini;

1. **Ne emër të L.M(motra e te dyshuarit F.M)** figuron pasuria e ndodhur ne ZK(.....) (.....), volum 66, faqe 49, **lloji i pasurisë dyqan me sipërfaqe 61 m2**, blere sipas

kontrates se dates 08.11.2013, me Nr.rep/kol/3060/736 pranë Noteres Shpresa Kurti, Dhoma e Noterise Tirane;

- 1. Ne emer te shtetases L.M(motra e shtetasit F.M)** figuron pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (.....), volum 66, faqe 78, **lloji i pasurisë dyqan me sipërfaqe 79.8 m2**, blere sipas kontrates se dates 08.11.2013, me Nr.rep/kol/3061/736 pranë Noteres Shpresa Kurti, Dhoma e Noterise Tirane.

Nga te dhenat e siguruara , Gjykata cmon se ka dyshime te bazuara ne prova se pasurite e paluajtshme ne emer te familjareve te te dyshuarit F.M jane krijuar mbi bazën e të ardhurave të siguruara nga aktiviteti kriminal i këtij shtetasi ne drejtim te tregtimit dhe trafikimit te lëndëve narkotike. Nisur nga aktivitetit kriminal i te dyshuarit F.M, shumat e mëdha të investuara për blerje të pasurive të paluajtshme e të luajtshme, transaksionet e kryera me ato, të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike sepse nuk identifikohen burime të ligjshme të ardhurash për të siguruar këto pasuri, sigurimi ose krijimi i ketyre pasurive pas periudhes se dyshuar kriminale dhe per me teper hedhja dhe rregjistrimi i ketyre pasurive ne emer te prinderve pensioniste si motres se te dyshuarit F.M krijohet dyshimi i arsyeshem dhe i bazuar ne prova se burimi i krijimit te ketyre pasurive jane te ardhurat e siguruara nga aktiviteti kriminal i ketij te dyshuari.

Organi i akuzës në mbështetje të nenin 274/2 të Kodit te Procedures Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal , vlerëson të nevojshme vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e pershkruara me lart duke qene se disponimi i lire i tyre mund te rendojë dhe zgjase pasojat e vepres penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal duke sjelle tjetersimin ose transferimin e tyre tek persona te trete.

Rezulton nga çertifikata familjare date 18.01.2013 , leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Bashkiake nr. 5 Tirane, qe shtetasit P.M i vitlindjes (...) dhe E.M e vitlindjes (...)te jene prinderit e personit nen hetim F.M.

Gjykata si administroi provat shkresore bashkalidhur kerkesës cmon se kërkesa mbështet ne ligj e prova dhe duhet te pranohet . Ajo mbështet ne Nenin 274 pika 1, 2 i Kodit te Procedures Penale. Kjo dispozitë parashikon rastet e vendosjes se sekuestros preventive mbi pasurite qe mund te lejohen te konfiskohen, sipas percaktimeve te nenit 36 te Kodit Penal. Kjo dispozite penale, mes te tjerash ne piken 1.b.ç te saj, parashikon si sende te konfiskueshme ***çdo pasuri tjeter, vlera e se ciles korrespondon me ate te produkteve te vepres penale.***

Nisur nga sa me lart, pasuritë e paluajtshme të regjistruar ne ZVRPP Tiranë dhe Durrës ne emer te gjinisë së afërt të personit nen hetim , perben pasuri mbi te cilen mund te vendoset sekuestro preventive. Nepermjet kesaj mase, urdherohet ZVRPPTiranë dhe ZVRPPDurrës , te mos lejoje tjetersimin e kesaj pasurie, per llogari te procedimit penal nr. 2881 të vitit 2013. Per rrjedhoje, gjykata, ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses arrin ne perfundimin se plotesohen kushtet dhe kriteret ligjore te percaktuara ne nenet 274 te Kodit te Procedures

Penale dhe nenit 36 te Kodit Penal, per vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e paluajtshme te regjistruara ne ZVRPP Tiranë, Durrës, ne pronesi te shtetasve P.M, E.M dhe L.M.

PËR KËTO ARSYE

Konform nenit 274 te K.Pr.Penale dhe nenit 36 te Kodit Penal

VENDOSI

- Pranimin e kerkeses se Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e paluajtshme te regjistruara *ne ZVRPP Tiranë dhe ZVRPP Durrës*, ne emer te shtetasve *P.M, E.M, L.M* si me poshte:
 - 1- Në emër të P.M** pasuria e ndodhur ne ZK (.....) (.....), **Tiranë** pasuria me nr(.....), volum 16, faqe 209, lloji i pasurisë **arë me sipërfaqe 1200 m2** blere sipas kontrates se dates 18.09.2008, me Nr. rep/kol 4084/1074, pranë Noterit Vangjel Daka ne Tirane;
 - 2- Në emër të P.M** pasuria e ndodhur ne ZK (.....) (.....), **Tirane** me nr. (.....), volum 16, faqe 1, lloji i pasurisë **arë me sipërfaqe 96 m2** blere sipas kontrates se dates 24.05.2005, me Nr.rep/kol /7117/1750 pranë Noteres Mimoza Shehu, Dhoma e Noterise Tirane;
 - 3- Ne emer te P.M**, pasuria e ndodhur ne ZK (.....) (.....), volum 19, faqe 187, lloji i pasurisë **apartament banimi me sipërfaqe 130 m2**;
 - 4- Ne emer te P.M**, pasuria e ndodhur ne ZK (.....) (.....) **Tiranë** pasuria me nr.(.....), volum 7, faqe 131, lloji i pasurisë **apartament me sipërfaqe 82 m2** blere sipas kontrates se dates 03.04.2002, me Nr.rep/kol/1179/157 pranë Noterit Xhevdet Hamzaj;
 - 5- Ne emer te P.M** pasuria e ndodhur ne ZK(.....) (.....), **Tiranë** pasuria me nr. (.....), volum 9, faqe 247, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 355 m2** blere sipas kontrates se dates 15.01.2004, me Nr.rep/kol/52/11 pranë Noteres Edlina Nini;
 - 6- Në emër të E.M** pasuria e ndodhur ne ZK (.....) (.....), **Tirane** me nr. (.....), volum 5, faqe 133, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 13 000 m2** blere sipas kontrates se dates 05.10.2006, me Nr.rep/kol/757/72 pranë Noteres Edlira Hyseni, perfaqësuar *nga vete i dyshuari F.M* me Prokure të Përgjithshme me Nr.1249/276, datë 19.06.2006;
 - 7- Ne emër të L.M** pasuria e ndodhur ne ZK(.....) (.....), **Tiranë** volum 66, faqe 49, **lloji i pasurisë dyqan me sipërfaqe 61 m2**, blere sipas kontrates se dates

08.11.2013, me Nr.rep/kol/3060/736 pranë Noteres Shpresa Kurti, Dhoma e Noterise Tirane;

- 8-** Ne emer te shtetases **L.M** pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (.....), **Tiranë** , volum 66, faqe 78, **lloji i pasurisë dyqan me sipërfaqe 79.8 m2**, blere sipas kontrates se dates 08.11.2013, me Nr.rep/kol/3061/736 pranë Noteres Shpresa Kurti, Dhoma e Noterise Tirane.
- 9-** Ne emer te **P.M**, pasuria e ndodhur ne ZK.(.....) (.....),**Durrës** volum 4, faqe 8, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 745 m2** blere sipas kontrates se dates 24.05.2005, me Nr.rep/kol/7117/1750 pranë Noteres Mimoza Shehu, Dhoma e Noterise Tirane;
- 10-** Ne emer te **P.M**, pasuria e ndodhur ne ZK(.....) (.....), **Durrës** volum 4, faqe 5, lloji i **pasurisë arë me sipërfaqe 1515 m2** blere sipas kontrates se dates 24.05.2005, me Nr.rep/kol/7714/1741 pranë Noteres Mimoza Shehu, Dhoma e Noterise Tirane;
- 11-** Në emër të **E.M** pasuria e ndodhur ne ZK. (.....)(.....), **Durrës** pasuria me nr.(.....), volum 14, faqe 143, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 710 m2**, blere sipas kontrates se dates 01.02.2005, me Nr. rep/kol/887/315 pranë Noteres Mimoza Shehu;
- 12-** Në emër të **E.M** pasuria e ndodhur ne ZK.(.....)(.....), **Durrës** pasuria nr. (.....), volum 14, faqe 140, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1800 m2**, blere sipas kontrates te se njejtës date 01.02.2005, me Nr.rep/kol/882/316 pranë Noteres Mimoza Shehu.
- 13-** Në emër të **E.M** pasuria e ndodhur ne ZK(.....) (.....),**Durrës** pasuria nr. (.....), volum 14, faqe 137, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1231 m** blere sipas kontrates se dates 01.02.2005, me Nr.rep/kol/886/314 pranë Noteres Mimoza Shehu;
- 14-** Në emër të **E.M** pasuria e ndodhur ne ZK. (.....) (.....), **Durrës** pasuria me nr. (.....) volum 17, faqe 125, **lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 260 m2**, e perfaqësuar nga F.M me Prokure të përgjithshme me Nr.1249/276, datë 19.06.2006, te noterës Adelina Nini;

Urdherohet ZVRPP Tiranë dhe ZVRPPDurrës te mos lejojnë kryerjen e veprimeve të tjetërsimit mbi pasuritë e mesiperme.

Ngarkohen Oficeret e Policisë Gjyqësore te Sektorit për Krimin Ekonomik dhe Financiar ne Drejtorine e Pergjithshme te Policisë se Shtetit për ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi .

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

Tiranë, me 16.07.2014

SEKRETARE

GJYQTARE

IRENA RAFTI

REGLETA PANAJOTI